



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA**

VENDIM
Nr. 15, datë 09.06.2014

**PËR ZBATIMIN E KONTRATES MODEL TE MIRATUAR NGA KKRR PER TE
GJITHE KLIENDET E SEKTORIT TE FURNIZIMIT ME UJE DHE LARGIMIT E
PERPUNIMIT TE UJERAVE TE NDOTURA**

Në mbështetje të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, në nenin 3, nenin 13/ pika d, nenin 14/ pika e, i, j dhe Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë në nenet 663 - 676 të tij, Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Marrëdhënia juridike e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura midis operatorëve dhe klientëve rregullohet në bazë të kontratës model të miratuar me vendimin e KKRR nr. 8, datë 04.02.2011, " Për miratimin e modelit të kontratës tip".
2. Pika 5 e vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 8, datë 04.02.2011, "Për miratimin e modelit të kontratës tip" shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi në 1 shtator 2014.

KRYETARI
Avni Dervishi